



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 707, datë 04.12.2023

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e

çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjorë në vendimet burim vlerësimi për gjyqtaren {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Në 3 dokumentet ligjore dhe në 4 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtare {...}, kualifikon drejt marrëdhënien juridike objekt shqyrtimi gjyqësor (shih dokumentet 1-3 dhe dosjet 1, 2, 4 dhe 5)... Kur është rasti, përdor edhe ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre (shih dokumentet 1-3 dhe dosjet 1-5). Gjyqtarja përgjithësisht, identifikon saktë rastet kur marrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i Punës (shih dosjen 5), si dhe arrin të bëjë dallimin midis një akti administrativ të mirëfilltë me një akt që përfaqëson një marrëdhënie pune (shih dosjet 3 e 5)”.

- **Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:**

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, rezulton se gjyqtarja përpara përcaktimit të fakteve të çështjes pasqyron procedurën e ndjekur dhe vendimet e marra në funksion të zbatimit të saj. Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, në të cilën, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) shqyrtimin e kërkesave të palëve gjatë gjykimit për marrjen e masës së sigurimit të padisë,¹ (ii) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për ndryshimin, shtimin, apo saktësimin e objektit të padisë,² etj.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron faktet e çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Faktet e çështjes në çdo rast janë paraqitur në mënyrë kronologjike, duke integruar në përmbajtje të tyre, edhe provat e administruara mbi bazën e të cilave nga gjykata është vlerësuar se provohet fakti konkret, si dhe duke cituar në disa raste edhe pjesë të përmbajtjes së provave shkresore apo në raste të veçanta edhe të provave të tjera, sikurse është ekspertimi.³

¹Vendimi nr.3336, datë 27.06.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²Vendimet nr.3336, datë 27.06.2016, nr.1540, datë 24.03.2015, nr.5490, datë 21.11.2016, dhe nr.6292, datë 28.12.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³Vendimet nr. 6292, datë 28.12.2016, nr.4344, datë 26.09.2016, nr.5490, datë 21.11.2016, nr. 3336, datë 27.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Pas përshkrimit të fakteve të çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, elementë të faktit të provuar, bëhen pjesë e analizës ligjore dhe konkluzioneve të gjykatës, në vlerësimin e çështjeve me natyrë procedurale sa i përket parakushteve ligjore për ngritjen e padisë (element të tillë si afati i paraqitjes së padisë, ezaurimi i ankimit administrativ kur e parashikon ligji, etj.), ashtu edhe analizës për faktet thelbësore të çështjes konkrete.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja identifikon dhe përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, pas paraqitjes së rrethanave procedurale, analizës së faktit dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, duke analizuar objektin dhe shkaku e padisë, si dhe përmes gjithë analizës së kuadrit ligjor mbi të cilin themelohet kërkimi. Në këtë kontekst, në lidhje me detyrimin e gjykatës për përcaktimin e saktë të shkakut ligjor të padisë, gjyqtarja referon vendimin unifikues nr.3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.⁴ Në çdo rast, përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet duke evidentuar qartë aktin, veprimin, mosveprimin administrativ apo marrëdhënien juridike të punës, si pasojë e të cilit pala paditëse ka ngritur pretendimet objekt padie duke kërkuar sipas rastit, pavlefshmërinë absolute ose relative të aktit, detyrimin e organit administrativ për të kryer ose mos kryer një veprim administrativ apo zgjidhjen e pasojave që vijnë nga zgjidhja e marrëdhënies së punës apo marrja e masave disiplinore ndaj punëmarrësit. Ky përcaktim i shprehur i natyrës së mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, në disa raste duke konkluduar për të si pasojë e një arsyetimi paraprak lidhur me kërkimet objekt padie dhe ligjin e aplikueshëm, e bën të qartë prezantimin e natyrës së konfliktit, si dhe orienton në vijim arsyetimin e vendimit dhe në disa raste, edhe çështjet ligjore të ngritura për zgjidhje.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se pas pasqyrimin të fakteve të çështjes dhe pretendimeve të palëve në gjykim, gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Administrative, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Civil, të Kodit të Punës që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Konkretisht, në vendimet burim vlerësimi, identifikohen, referohen dhe citohen dispozitat me karakter procedural dhe material, si më poshtë:

- nenet 7, 8, 10 dhe 11 të ligjit nr.49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në lidhje me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësor të gjykatës;⁵ nenin 47 të K.Pr.Civile dhe 7 të K.Punës lidhur me kompetencën tokësore të gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve me objekt marrëdhënie pune;⁶ nenin 14 të ligjit 49/2012 dhe nenin 55 të K.Pr.Civile në lidhje me vendimmarrjen për bashkimin e çështjeve në një çështje të vetme;⁷
- nenin 20 të K.Pr.A në lidhje me parimin procedural të dëgjimit të palëve,⁸ nenin 37 të ligjit nr. 49/2012, në lidhje me kufijtë e shqyrtimit nga gjykata mbi ligjshmërinë e veprimit administrativ;⁹
- nenin 105 të K.Pr.Administrative në lidhje elementet e aktit administrative, nenin 608 të K.Civil në lidhje me shkaktimin e dëmit dhe 609 të K.Civil në funksion të përcaktimit të dy kritereve që duhet të

⁴Vendimi nr.2998, datë 13.06.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁵Dispozitat procedurale lidhur me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësore referohen në çdo vendim burim vlerësimi

⁶Vendimi nr.2548, datë 12.05.2015, nr.2622, datë 26.05.2016, nr.2230, datë 09.05.2016 dhe nr.1300, datë 12.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁷Vendimi nr.4344, datë 26.09.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁸Vendimi nr.4435, datë 03.10.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁹Vendimi nr.4344, datë 26.09.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

ekzistojnë në mënyrë kumulative për të ekzistuar dëmi jashtëkontraktor (*i drejtpërdrejt dhe i menjëhershëm*);¹⁰

- nenin 46 të K.Pr.Administrative në lidhje me të drejtën e organit administrativ që të fillojë procedim administrativ edhe me nismën e tij, nenin 85/2 të K.Pr.A në lidhje me detyrimin e organit administrativ për t'i kërkuar vet provat dhe faktet;¹¹
- nenin 659 të K.Civil lidhur me përkufizimin e kontratës, nenet 6 dhe 151 të K.Pr.Administrative lidhur me konceptin e kontratave administrative, si dhe me llojet e kontratave që organet administrative publike mund të lidhin;¹² nenin 92 të K.Civil në lidhje me pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, nenin 115/dh të K.Civil dhe nenin 18/4 të ligjit 49/2012 në lidhje me afatin e parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor;¹³
- nenin 450 të K.Civil në lidhje me kamatat ligjore;¹⁴
- nenin 420 të K.Civil në lidhje me burimin e detyrimeve, nenin 608 të K.Civil në lidhje me shkaktimin e dëmit, nenin 640 të K.Civil në lidhje me shpërblimin e dëmit pasuror, nenet 611, 612 të K.Civil në lidhje me rastet kur një veprim apo mosveprim edhe pse mund të jetë i paligjshëm nuk mund të sjell përgjegjësinë e dëmtuesit (*mbrojtja e nevojshme dhe nevoja ekstreme*);¹⁵
- nenet 4, 5, 6, 23, 24, 26, 28-31, 140, 141, 143, 144, 145, 153, 155 të Kodit të Punës, në funksion të vlerësimit mbi zbatimin e Kodit të Punës në kohë, ndaj personave dhe sipas materies, në lidhje me detyrimet e punëmarrësit që rrjedhin nga kontrata e punës, afatin e zgjidhjes së kontratës së punës, procedurën, shkaqet e zgjidhjes së kontratës, pasojat që vijnë prej zgjidhjes së marrëdhënies së punës;¹⁶
- nenet 116 dhe 117 të K.Pr.Administrative mbi shkaqet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, nenin 36/2 i K.Pr.Civile në lidhje me ndalimin e kryerjes së një procedure administrative ndërkohë që mosmarrëveshja civile është duke u gjykuar nga gjykata, nenin 111 dhe 113 të K.Pr.Administrative në lidhje me hyrjen në fuqi të aktit administrativ dhe efektin e vonuar, nenin 78 të K.Pr.A lidhur me kompetencën e organit administrative për marrjen e masave të ndërmjetëm;¹⁷
- nenin 45 të ligjit 49/2012 lidhur me vendimet e paankimueshme.

Gjyqtarja identifikon dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve, si me poshtë:

- nenet 1, 2, 3/c, 4, 5 dhe 6 të ligji nr. 9381, datë 28.04.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë” në lidhje me të drejtën për kompensim për burgim të padrejtë, lidhur me konceptin “*burgim i padrejtë*”, rrethanat që përjashtojnë të drejtën e kompensimit, si dhe kriteret për përcaktimin e masës së kompensimit;¹⁸
- nenet 57 dhe 58 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” lidhur me masat disiplinore dhe llojet e tyre;¹⁹
- ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në drejtim të vlerësimit të shkeljeve të evidentuara;²⁰
- nenin 2 të ligjit nr. 8290, datë 24.02.1998 “Për përdorimin e armëve të zjarrit” lidhur me të drejtën e forcave të armatosura për përdorur armët e zjarrit për të mbrojtur jetën, shëndetin, të drejtat dhe

¹⁰Vendimi nr.3336, datë 27.06.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹¹Vendimi nr.1137, datë 03.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹²Vendimet nr.6603, datë 28.12.2015 dhe nr.1540, datë 24.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹³Vendimi nr.1540, datë 24.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹⁴Vendimi nr.5490, datë 21.11.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹⁵Vendimi nr.6292, datë 28.12.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹⁶Vendimi nr.1300, datë 12.03.2015, nr. 2230, datë 09.05.2016, nr.2622, datë 26.05.2016, nr.2548, datë 12.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

¹⁷Vendimi nr.4344, datë 26.09.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹⁸Vendim nr.3090, datë 16.06.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹⁹Vendimi nr.4435, datë 03.10.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²⁰Vendimi nr.2230, datë 09.05.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

interesat e tyre dhe të një tjetri nga një sulm i padrejtë, i vërtet dhe i çastit, me kush që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit (*në kushtet e mbrojtjes së nevojshme*), si dhe kur u kërkohet për të përballuar një rrezik real dhe të çastit, që kërcënon atë ose një person tjetër apo pasurinë e tyre nga një dëmtim i rëndë, me kusht që të mos jetë i provokuar prej tij dhe dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi i zmbarsur (*në kushtet e nevojës ekstreme*); ligjin nr.8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”;²¹

- ligjin nr.9258, datë 25.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizimit”, në lidhje me përcaktimin e mënyrës së përdorimit të pasurisë që i nënshtrohet sekuestrimit dhe konfiskimit, VKM nr.140, datë 13.02.2008 “Për mënyrën e administrimit të pasurive të paluajtshme, të sekuestruara në kuadër të luftës kundër financimit të terrorizimit” dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.27, datë 23.09.2008 “Për procedurat dhe limitet e kryerjes së shpenzimeve, Rregullat për mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave, Rregullat për mënyrën e mbajtjes dhe evidentimit të shpenzimeve dhe të ardhurave dhe Procedurat e kontraktimit të personave të jashtëm dhe shërbimeve të tjera”;²²
- ligjin 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” lidhur me dy llojet e kontratave administrative të parashikuara nga ky ligj (*prokurim i punëve publike dhe prokurim i shërbimeve publike*), lidhur me përcaktimin e konceptit “Prokurim” dhe “Ent prokurues”,²³ ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” në lidhje me faturën tatimore me TVSH dhe lëshimi i faturës tatimore;²⁴
- dispozitat e ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurisë të paluajtshme”, (*ligji i kohës së lëshimit të certifikatës së pronësisë*) dhe VKM nr.1025, datë 09.07.2008 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”;²⁵
- dispozitat e ligjit nr.9947, datë 07.07.2008 “Për procesin industriale”, i ndryshuar, dhe VKM nr.1706, datë 29.12.2008 “Për miratimin e rregullores për regjistrimin e markave tregtare dhe të shërbimit”, i ndryshuar, si kuadri ligjor që normon procesin e regjistrimit të markës, kundërshtimin ndaj një marke të publikuar, duke identifikuar elementet kryesorë në krijimin e karakterit dallues të markës,²⁶ etj.

Krahas dispozitave dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në lidhje me të drejtën e pronës;²⁷
- nenin 17 të Kushtetutës, në lidhje me kufizimin e të drejtave dhe lirive, por pa tejkaluar në asnjë rast kufizimet e parashikuara në KEDNJ dhe nenin 122 të Kushtetutës lidhur me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar si pjesë përbërëse e sistemit të brendshëm juridik dhe epërsisë së tyre mbi ligjet e në rastet kur nuk pajtohen me të; nenin 2 të KEDNJ në lidhje me të drejtën e jetës; nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ në lidhje me kuptimin autonom të “pronës”;²⁸
- nenin 116 të Kushtetutës lidhur me hierarkikën ligjore;²⁹
- nenin 107 të Kushtetutës lidhur me detyrimet themelore që duhet të udhëheqin nëpunësin civil;³⁰

²¹Vendimi nr.6292, datë 28.12.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²²Vendimi nr.5490, datë 21.11.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²³Këto dispozita identifikohen edhe në vendimin nr.1540, datë 24.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²⁴Vendimi nr.6603, datë 28.12.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²⁵Vendimi nr.2998, datë 13.06.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²⁶Vendimi nr.6025, datë 15.12.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²⁷Vendimi nr.2998, datë 13.06.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²⁸Vendimi nr.6292, datë 28.12.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²⁹Vendimi nr.6292, datë 28.12.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁰Vendimi nr.4435, datë 03.10.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

- nenin 44 të Kushtetutës, në lidhje me të drejtën e çdo individi për tu zhdëmtuar në përputhje me ligjin për dëmin e pësuar për shkak të një akti të paligjshëm të organeve shtetërore dhe nenin 5 të KEDNJ, në lidhje me të drejtën për liri dhe siguri të personit.³¹

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe përshkrimin e tyre në mënyrë koncize, duke i referuar ato si ekstrakt të fakteve që kanë rezultuar nga administrimi dhe vlerësimi në mënyrë të integruar i provave të administruara në gjykim, duke evidentuar nëpërmjet referimit, provat mbi të cilat bazohet fakti konkret. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në përcaktimin e natyrës juridike të marrëdhënies objekt shqyrtimi, përcaktim të cilin e bën në mënyrë të shprehur, duke e referuar si konkluzion të analizës së saj mbi objektin dhe shkakun ligjor të padisë. Rezultojnë aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore, që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

³¹Vendimi nr.3090, datë 16.06.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka shfaqur aftësitë e duhura në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit...Ajo njih dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit, siç është parimi i legjitimitetit të palëve (shih dokumentet 1-3). Analizon nga pikëpamja ligjore aktin administrativ dhe arsyeton rastin kur ai është absolutisht i pavlefshëm nëpërmjet argumentimeve përkatëse ligjore (shih dokumentin nr.1)...Kur është rasti, gjyqtare {...}, në zgjidhjen e çështjes, referon në praktikën unifikuere të Gjykatës së Lartë (shih dokumentin 3). Në dy çështje të gjykuara, gjyqtarja {...} ka bërë referencë dhe ka përdorur si argumenta për zgjidhjen e çështjes edhe vendime të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (shih dokumentin 3). Në një rast, kur është dashur të sqarojë konceptin “interes publik” gjyqtarja ka referuar në sqarimin këtij koncepti nga Gjykata Kushtetuese (shih dokumentin 1). Tre dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë a) në të drejtën administrative, ky bien në sy pavlefshmëria e aktit administrativ (shih dokumenti 1); kontrata administrative (shih dosjet 2 dhe 4); legjislacioni për komunikimet elektronike (shih dokumentin 1); legjislacioni i prokurimit publik (shih dosjen 2); ligjin për procedurat tatimore (shih dosjen 4); b) në të drejtën e punës, ku njih dhe zbaton dispozitat e K.Punës (shih dosjet 3 dhe 5); c) njohuritë në të drejtën civile, sidomos lidhur me dallimet mes përgjegjësive kontraktore e jashtëkontraktore, shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, etj., (shih dokumentin 3 dhe dosjet 2 e 4), etj.”.*

- **Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:**

Në vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Në çdo rast, citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*), por edhe interpretimin literal apo sistematik të normave, interpretim i cili duke e përqsaur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, sjell si pasojë logjike konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Në lidhje me dispozitat materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes evidentohet se interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja:

- interpreton dispozitat e ligjit nr.9258, datë 25.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizimit” duke analizuar jo vetëm qëllimin e këtij ligji për “parandalimin” dhe “goditjen” e terrorizimit por edhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të pasurive që i nënshtrohen sekuestrimit dhe konfiskimit, në mënyrë që vlera e këtyre pasurive të mos të zvogëlohet apo të humbasë;³²

³²Vendimi nr.5490, datë 21.11.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

- merr në analizë konceptin e aktit administrativ si një e drejtë thelbësore e të drejtës administrative e për këtë qëllim interpreton në mënyrë literale nenin 105 të K.Pr.Administrative;³³
- interpreton nenet 4, 5 dhe 6 të K.Punës, në lidhje me zbatimin e Kodit të Punës, sipas personave, sipas përmbajtjes dhe në kohë, duke konkluduar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi do të zbatohet ligji Kodi i Punës; interpreton nenet 23, 24 dhe 26 të K.Punës lidhur me detyrimet e punëmarrësit në bazë të kontratës së punës (*detyrimi i bindjes, i kujdesit, i besnikërisë, i konfidencialitetit dhe ndalimi i konkurrencës*). Interpreton nenet 141, 143, 144, 145, 153, 154, 155 të Kodit të Punës, në drejtim të vlerësimit të natyrës së marrëdhënies së punës, llojin e kontratës, respektimin e afatit për zgjidhjen e kontratës së punës, procedurën që duhet të ndjehet punëdhënësi, përcaktimin dhe vlerësimin e shkaqeve të justifikuar, pasojat e mosrespektimit të dispozitave përkatëse në raport me kërkimet e punëdhënësit për përfitimin e shpërblimeve dhe dëmshpërblimeve përkatëse;³⁴
- interpreton nenet 4 dhe 37 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, për të konkluduar se ndërprerja e marrëdhënieve të punës së paditësit vjen në kundërshtim me këtë ligj;³⁵
- në funksion të përcaktimit të natyrës së pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ gjyqtarja interpreton në mënyrë literale nenin 116 të K.Pr.Administrative, duke referuar edhe praktikën e Gjykatës së Lartë vendimin nr.399, datë 25.06.2014. Interpreton nenet 111 dhe 113 të K.Pr.Administrative në lidhje me hyrjen në fuqi të aktit administrativ dhe efektin e vonuar, duke u kushtëzuar nga faktor, ngjarje, apo faza të ndryshme të procedurës, vërtetimi i të cilave pritet të realizohet detyrimisht në një kohë të ardhme. Interpreton në mënyrë literale nenin 117 të K.Pr.A në funksion të analizës se aktet administrative absolutisht të pavlefshme nuk prodhojnë pasoja ligjore pavarësisht nga fakti nëse janë deklaruar apo jo si të tilla;³⁶
- interpreton nenin 608 të K.Civil në funksion të trajtimit të elementëve të padisë së kërimit të dëmit jashtëkontraktor, duke përcaktuar kushtet për pasjen e dëmit jashtëkontraktor, e përkatësisht faktin e paligjshëm, dëmin e paligjshëm, lidhjen shkakësore dhe fajin, duke u ndalur në analizën e detajuar të konceptit të dëmit të paligjshëm.³⁷ Gjyqtarja interpreton për këtë qëllim nenet 611 dhe 612 të K.Civil lidhur me mbrojtjen e nevojshme dhe nevojën ekstreme, si raste të veçanta që mund ta përjashtojnë nga përgjegjësia dëmtuesin. Lidhja shkakësore është një kusht tjetër i domosdoshëm për të ekzistuar dëmi jashtëkontraktor dhe në këtë kuadër me qëllim përcaktimin e kriterëve që duhet të ekzistojnë së bashku që të ekzistojë lidhja shkakësore (*i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm*) gjyqtarja interpreton nenin 609 të K.Civil;³⁸
- gjyqtarja referon dhe interpreton neni 44 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën kushtetuese të çdo individit për tu zhdëmtuar në përputhje me ligjin dhe dëmet e pësuar për shkak të një akti të paligjshëm të organeve shtetërore. Në këtë drejtim gjyqtarja referon edhe nenin 5 të KEDNJ. Po ashtu, në këtë vendim, në funksion të zgjidhjes së çështjes, interpreton në mënyrë sistematike nenet 3 dhe 4 të ligjit nr.9381, datë 28.04.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”, në funksion të përcaktimit të rrethanave, ekzistenca e të cilave përjashton të drejtën e kompensimit a) dhënia e vendimit të gabuar është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij dhe b) moszbulimi në kohën e duhur i fakteve të panjohura, shqyrtimi i të cilave nuk do ta

³³Vendimi nr.3336, datë 27.06.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁴Vendimet nr. 2230, datë 09.05.2016, nr. 1300, datë 12.03.2015 dhe nr.2622, datë 26.05.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁵Vendimi nr.2230, datë 09.05.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁶Vendimi nr.4344, datë 26.09.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁷Kjo dispozitë interpretohet edhe në vendimet nr.5490, datë 21.11.2016 dhe nr.3336, datë 27.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁸Vendimi nr.5042, datë 27.12.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

çonte gjykatën në marrjen e vendimit të gabuar, është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij;³⁹

- interpreton nenin 52 të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, në funksion të përcaktimit të qëllimit të tij në drejtim të përcaktimit të rregullave për kërkesën për regjistrimin dhe shqyrtimin e kundërshtimit të një marke, duke referuar dhe interpretuar në këtë drejtim edhe nene të veçanta të VKM-së nr.1706, datë 29.12.2007 “Për miratimin e rregullores për regjistrimin e markave tregtare dhe të shërbimit”, i ndryshuar;⁴⁰
- interpreton në mënyrë literale nenin 659 të K.Civil me qëllim përkufizimin e kontratës të së drejtës private dhe nenet 6 dhe 151 të K.Pr.Administrative në lidhje me kuptimin dhe përmbajtjen e konceptit të kontratës administrative, si dhe llojet e kontratave administrative që lidhen nga organet e administratës publike. Gjyqtarja merr në analizë dallimet midis kontratës administrative dhe kontratës private, në funksion të përcaktimit nëse dëmi i pretenduar në rastin objekti gjykimi ka karakter kontraktor apo jashtëkontraktor.⁴¹

Në lidhje me normat procedurale, gjyqtarja ka interpretuar dispozitat në disa raste, si më poshtë:

- interpreton nenin 7 të ligjit nr.49/2012 për të konstatuar kryesisht kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes, interpretim të cilin gjyqtarja e bën në çdo rast në formën e një konkluzion të arritur nga vlerësimi kryesisht i çështjes;
- interpreton nenin 37 të ligjit nr. 49/2012, në lidhje me kufijtë e shqyrtimit nga gjykata mbi ligjshmërinë e veprimit administrativ; interpreton nenin 32 të K.Pr.Civile në lidhje me të drejtën për ngritjen e padisë;⁴²
- interpreton nenin 18/4 të ligjit 49/2012, në shërbim të vlerësimit se padia për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor është paraqitur në gjykatë jashtë afatit të përcaktuar dhe si rrjedhojë gjykata ka disponuar për rrëzimin në themel të padisë;⁴³
- interpreton nenin 317 të K.Pr.Civile në lidhje me kërkesën për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm;⁴⁴ etj.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- në vendimin nr.6292, datë 28.12.2016, gjyqtarja referon vendimin e GJEDNJ “Bekirski kundër Bullgarisë”, “Mcan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar”, në lidhje me të drejtën për jetën, vendimin e GJEDNJ “Oneryddiz kundër Turqisë” dhe “Budayeva dhe të tjerë kundër Rusisë” në lidhje me përgjegjësinë e shteteve për marrjen e të gjitha masave të nevojshme për shmangien e humbjes së jetës; vendimi unifikues nr. 12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me dëmin jashtëkontraktor;
- në vendimin nr.5490, datë 21.11.2016 gjyqtarja referon vendimin nr.31, datë 18.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me të drejtën e pronësisë, si një e drejtë kushtetuese jo absolute, vendimin e GJEDNJ “Qufaj & Co kundër Shqipërisë” lidhur me procesin e ri regjistrimit të shoqërisë tregtare duke njohur cilësinë si të dëmtuar të subjekti ankimes;

³⁹Vendim nr. 3090, datë 16.06.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁰Vendimi nr.6025, datë 15.12.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴¹Vendimet nr.1540, datë 24.03.2015 dhe nr.6603, datë 28.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴²Vendimi nr.4344, datë 26.09.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴³Vendimet nr.1540, datë 24.03.2015 dhe nr.1103, datë 04.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁴Vendimi nr.6292, datë 28.12.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

- në vendimin nr.4344, datë 26.09.2016 gjyqtarja referon vendimin nr.2, datë 18.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me konceptin kushtetues të “*Interesit publik*”, vendimin nr.30, datë 13.01.2005 të Gjykatës së Lartë, lidhur me kuptimin e “*Interesit juridik*”;
- në vendimin nr.2998, datë 13.06.2016 në lidhje me përgjegjësinë e gjykatës për përcaktimin e shkakut ligjor të padisë, pa u lidhur me pretendimet e palëve, krahas përcaktimit të natyrës së mosmarrëveshjes në raport me shkakun ligjor të saj, gjyqtarja referon vendimi unifikues nr.3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- në vendimin nr.6025, datë 15.12.2016 gjyqtarja referon vendimin nr.2236, datë 25.05.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës në çështjen me objekt gjykimi;
- në vendimin nr.1103, datë 04.03.2015 dhe vendimin nr.1137, datë 05.03.2015 gjyqtarja referon vendimin nr.36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me parimin e sigurisë juridike, etj.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton se gjyqtarja zbaton *parimin e procesit të rregullt ligjor*, pasi referuar kontekstit të arsytimit të vendimeve, rezulton të jenë zbatuar drejtpërdrejt aspekte të tij në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, aksesin në gjykatë, kontradiktorialitetin, të drejtën e disponimit të padisë, barrën e provës, fuqinë provuese të provave të administruara në gjykim, etj. Në vendimet burim vlerësimi ka analizë të *parimit procedural të barrës së provës*, parim i cili referohet dhe analizohet në çdo vendim burim vlerësimi. Ky parim referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke përcaktuar në mënyrë të shprehur barrën e provës, në raport me parashikimet e ligjit të posaçëm nr.49/2012 apo Kodit të Punës në raste të veçanta, si dhe duke analizuar lidhur me mënyrën e zbatimit të tij referuar natyrës së çështjes. Po ashtu referohet dhe analizohet *parimi i prezumimit të pafajësisë* në kuadër të lehtësimit nga barra e provës për paditësin lidhur me fajin, pasi i takon të paditurit të provojë se ai nuk ka faj në shkakimin e dëmit;⁴⁵ *parimi i shpërblimit të drejtë*, në lidhje me masën e dëmshpërblimit si për dëmet pasurore, ashtu edhe për dëmet jopasurore;⁴⁶ *parimi procedural i dëgjimit të palëve*, shkelja e të cilit, në një kohë kur ligji e kërkon respektimin e tij, mund të çojë në nulitetin e aktit administrativ;⁴⁷ *parimi i ligjshmërisë*, i cili kërkon jo vetëm që autoritetet administrative të mos shkelin ligjin, por edhe që të gjitha aktet e nxjerra prej tyre të jenë të autorizuara nga ligji dhe përmbajtja e akteve të jetë në përputhje me ligjin;⁴⁸ *parimin e mirëbesimit* mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, në kuadër të analizës lidhur me shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës,⁴⁹ etj.

Lidhur me aspektin e njohurive ligjore, KPK për vendimet gjyqësore me nr.80-2015-4443, datë 09.12.2015 dhe nr.228, datë 26.01.2016 ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit lidhur me këto vendimmarrje gjendet në kushtet e pikës 2 të nenit 72, ligjit 96/2016. Në të dyja rastet konstatimet e KPK-së lidhur me shkakun për të cilin gjyqtarja ka vendosur “kthimin e akteve” lidhen me mënyrën se si prej gjyqtarës janë interpretuar nenet 154; 154/a dhe 158/a apo nenin 156 të K.Pr.Civile në lidhje me nenin 21 të ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Nga ana tjetër në të dyja çështjet gjyqtarja ka vendosur “kthimin e akteve” pasi e ka lënë padinë me të meta, duke i lënë afat palës për plotësimin e tyre. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore konstatohet se vendimmarrja e gjykatës bazohet jo vetëm në citimin, por edhe interpretimin e dispozitave në përputhje me njëra-tjetrën, duke analizuar mënyrën se si zbatohen dispozitat procedurale kur të metat e padisë konstatohen në momentin e paraqitjes së padisë, ashtu edhe kur të metat e padisë konstatohen gjatë gjykimit, sikundër është rasti i mospagimit të taksës mbi aktet kur

⁴⁵Ky parim referohet edhe në vendimin nr.5490, datë 21.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁶Vendimi nr.6292, datë 28.12.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁷Vendimi nr.4435, datë 03.10.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁸Vendimi nr.3336, datë 27.06.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁹Vendimi nr.1300, datë 12.03.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

vlera e padisë pëson rritje gjatë gjykimit. Nëse ky interpretim është ose jo i mbështetur në ligj, këtë e vlerëson një gjykatë më e lartë. Vlerësuesi nuk mund të zëvendësojë arsyen e logjikën e gjyqtarit. Çështja nëse shpenzimet për parapagimin e aktit të ekspertimit përfshihen brenda rrethit të shpenzimeve për “shërbimet e tjera gjyqësore” që parashikohen nga neni 156 i K.Pr.Civile, me pasojë kthimin e akteve nëse nuk parapagohen nga pala që ka investuar gjykatën apo nga ajo të cilës ato i ngarkohen duke marrë në konsideratë edhe natyrën e gjykimit të shpejtë të çështjeve administrative, ose janë të tilla që nuk lidhen me të metat e padisë, nuk mund të analizohet nga vlerësuesi, por vetëm nga një gjykatë më e lartë. Nëse gjyqtarja në këtë rast do të kishte vendosur “kthimin e padisë” pa ia njoftuar të metën paditësit apo pa interpretuar dispozitat procedurale, kjo situatë do të afektonte aftësinë e saj për të identifikuar dhe interpretuar ligjin e zbatueshëm. Lidhur me situatën tjetër juridike kur gjyqtarja ka vendosur kthimin e akteve, pasi nga pala nuk është paguar taksa shtesë mbi aktet, pas rritjes së vlerës së objektit të padisë, nuk konstatohet mungesë interpretimi nga ana e gjyqtarës dhe as nevojshmëri apo detyrim për të hetuar lidhur me aftësinë pagueuse të palës, pasi gjykimi ka qenë në një fazë të avancuar (pas realizimit të aktit të ekspertimit dhe pasi të gjitha shpenzimet gjyqësore ishin paguar prej vetë palës paditëse) dhe jo në momentin e paraqitjes së padisë, ndërkohë që nuk rezulton që pala paditëse t’i ishte drejtuar me kërkesë Komisionit për Ndhimën Juridike për të përfituar nga ndihma juridike falas në zbatim të ligji nr. 10039/2008, “Për ndihmën juridike”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuar, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të referuar, zbatuar dhe kur është rasti për të analizuar aspekte të procesit të rregullt ligjor, posaçërisht lidhur me elementin e barrës së provës, si dhe për të referuar parime të tjera procedurale dhe materiale, në mbështetje të interpretimit të dispozitave ligjore të zbatueshme. Në disa nga çështjet brumi vlerësimi, gjyqtarja ka referuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMILIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Gjyqtari duhet të ketë në konsideratë se e tërë dija e tij profesionale do të ketë vlerë nëse vendimi i tij është hartuar në një gjuhë të thjeshtëzuar dhe të kuptueshme.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre...Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor...”*.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe vendimet përfundimtare është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme për pjesëmarrësit në proces, si dhe për lexuesin.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuar (në kllapa), duke u shoqëruar gjithmonë me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre.⁵⁰ Termet teknike janë përdorur në mënyrë korrekte dhe vetëm në rastet kur përdorimi i tyre është i pashmangshëm, duke iu referuar ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që zbatohen mbi marrëdhënien objekt gjykimi.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Gjyqtarja përgjithësisht përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, duke i bërë vendimet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte në aspektin gjuhësor.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme dhe duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, si dhe paragrafët e vendimit me njëri-tjetrin. Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve dhe përdorimi i një gjuhe të qartë dhe të drejtpërdrejtë, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsyetimit të vendimeve, i bën në tërësi vendimet të kuptueshme, duke mos lënë hapësirë për kuptim të gabuar apo të ndryshëm të mendimit të shprehur.

⁵⁰P.sh: *lex aquilia de damno; alterim non laedere; nemitem laedere; restitutio in integrum; ratio legis; ratione personae; ratione materia; ratione temporis; etj.*

Në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, veç pjesës hyrëse dhe përshkruese arsyetuese të vendimit, evidentohet se në dispozitivin e vendimit gjyqtarja shprehet në mënyrë të plotë dhe koncize për të gjitha kërkimet e objekti të padisë në rastet e pranimit të saj, për cilësinë e vendimit si titull ekzekutiv, shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij në rastet kur vendimi është i ankimueshëm dhe për cilësinë e tij si vendim i paankimueshëm,⁵¹ kur vendimi ka këtë cilësi sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit të shprehur, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime logjike nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në shërbim të argumentimit të çështjeve të ngritura prej saj për zgjidhje, apo zgjidhjen tërësore të çështjes. Spikat konciziteti në paraqitjen e rrethanave të faktit, çka e bën natyrën e konfliktit lehtësisht të kuptueshëm për çdo lexues dhe jo vetëm për njohësit e ligjit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

⁵¹Vendimet nr. 4435, datë 03.10.2016 dhe nr.3090, datë 16.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Struktura e vendimit është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar”.

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:**

Vendimet përfundimtare, në aspektin strukturor kryesisht janë ndërtuar sipas një modeli të njëjtë, duke evidentuar qartë tri pjesët përbërëse të vendimit (*pjesa hyrëse, arsyetimi, pjesa urdhëruese*), sipas parashikimeve të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 40 dhe 41 të ligjit të posaçëm nr. 49/2012.

Në pjesën hyrëse të vendimit gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit të çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i mosmarrëveshjes administrative, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa nënpjesë, në të cilën në mënyrë të detajuar gjyqtarja ndalet në:

- (i) Analizën dhe vlerësimin kryesisht të çështjeve të juridiksionit, kompetencës, si dhe në evidentimin e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë, ndryshimin/pakësimin e objekti të padisë, etj.
- (ii) Faktet dhe rrethanat e provuara në gjykim, pjesë në të cilën rezulton se gjyqtarja përshkruan në mënyrë kronologjike dhe të detajuar dhe faktet e çështjes, duke integruar provat e administruara në gjykim, konkluzionet e aktit të ekspertimit sipas rastit, si dhe duke i analizuar ato në raport me faktet e vlerësuar si të provuara.
- (iii) Pretendimet dhe prapësimet e palëve, pjesë në të cilën gjyqtarja parashtron në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e secilës palë së bashku me argumentet e tyre.
- (iv) Analizën ose vlerësimin ligjor të gjykatës lidhur me çështjen. Pas evidentimit dhe analizës së elementëve procedurale, fakteve të çështjes dhe pretendimeve të palëve, arsyetimi vijon me një nënndarje përgjithësisht të titulluar “Arsyetimi ligjor”, në të cilin, gjyqtarja fillimisht a) citon ligjin material e procedural që zbatohen në çështjen konkrete, duke i referuar dispozitat materiale administrative dhe civile, por edhe ato të ligjit të posaçëm në të cilën të referon fakti juridik; b) merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke bërë interpretimin e tij, para aplikimit mbi faktet konkrete; c) për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen. Në një pjesë të vendimeve burim vlerësimi, gjyqtarja ka ndjekur metodën IRAC,⁵² duke shtruar, menjëherë pas përshkrimit të analizës së fakteve procedurale dhe thelbësore të çështjes, pyetjet/çështjet ligjore të vlerësuar thelbësore, për zgjidhjen e çështjes konkrete,

⁵²IRAC - Issue, Rule, Application, Conclusion

dhe duke organizuar më pas analizën ligjore në drejtim të përgjigjes së këtyre çështjeve/pyetjeve të shtruara për zgjidhje.⁵³

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarës dhe sekretarës gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), si dhe disponimi mbi shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi disponohet për të drejtën e ankimit sipas afateve ligjore ose për cilësinë e vendimit si i paankimueshëm.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij. Kjo mënyrë e standardizuar e të shkruarit të vendimit gjyqësor, orienton lexuesin dhe i shërben kuptueshmërisë së logjikës juridike për atë që është konkluduar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi; Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme. Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballtet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.⁵⁴

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;

⁵³Vendimet nr.2230, datë 09.05.2016 dhe nr.2548, datë 12.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁵⁴Vendimi i GJEDNJ, çështja *Hadjanastassiouvs Greqisë*, datë 16.12.1992, fq. 33

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, duke treguar se gjyqtarja ka qenë e vëmendshme ndaj kërkesave të tyre..... Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërmjetme gjithashtu shoqërohen me referencë ligjore dhe kur duhet jepen arsye për dhënien e tyre (shih 5 dosjet e vëzhguara)”*.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet e themelit është e detajuar, e plotë dhe gjithëpërfshirëse, duke integruar si pjesë të saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni për provueshmërinë e fakteve konkrete. Faktet e analizuar në pjesën e parë të vendimit, rimerren në analizë kur është e nevojshme, në pjesën argumentuese, duke i analizuar ato në raport me ligjin e aplikueshëm, qëllimin dhe kuptimin e tij.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsytimi, i plotë dhe i qartë, duke marrë në shqyrtim dhe dhënë arsye mbi çdo element të diskutueshëm në raport me aspektet procedurale apo faktet e çështjes, si dhe pretendimet e ngritura nga palët. Arsytimi i vendimeve, është ndërtuar mbi bazën e zhvillimi logjik të koncepteve ligjore duke identifikuar dhe analizuar në mënyrë më të gjerë konceptet thelbësore mbi të cilat arrihet me pas në konkluzione lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Arsytimi i vendimeve përfundimtare ndjek një organizim funksional dhe zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe atë material. Evidentohet kujdesi që gjyqtarja tregon në arsytim, për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Në vendimet burim vlerësimi, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të çështjes, si dhe kategorisë së saj apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike, duke u ndalur në mënyrë specifike edhe në aspektet procedurale lidhur me përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes, vlerësimin e kushteve procedurale për paraqitjen e padisë dhe përcaktimin e barrës së provës. Gjyqtarja jep argumente për secilin kërkim objekt padie, duke u ndalur në interpretimin e ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete si dhe lidhjen shkak- pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura mbi zgjidhjen e çështjes.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u parashtruar në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsytimit dhe më pas duke u marrë në analizë lidhur me bazueshmërinë ose jo të tyre, në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimin konkret. Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, në

disa raste si pjesë e arsytimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçuar të arsytimit, pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre. Në disa vendime gjyqësore argumenti rrjedh nga çështja apo pyetja ligjore e parashtruar nga ana e gjyqtares për zgjidhje dhe hap pas hapi evidentohet logjika me të cilin gjyqtarja i përgjigjet çështjes.

Lidhur me aspektin e arsytimit ligjor, KPK për vendimet gjyqësore me nr.4848, datë 05.10.2014 dhe nr.6603, datë 28.12.2015 (dosja 4) ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit lidhur me këto vendimmarrje gjendet në kushtet e pikës 3 të nenit 72, ligjit 96/2016.

- Konstatimi i KPK-së në çështjen e përfunduar me vendimin nr.4848, datë 05.10.2014 lidhet me mosformimin e rregullt të ndërgjyqësisë nga ana e gjyqtares, duke mos vlerësuar faktin se ndërgjyqësia e rregullt është një ndër parakusht procedural për vlefshmërinë e procesit gjyqësor civil dhe administrativ dhe sjell si pasojë e pushimit të gjykimit. Vlerësuesi nuk mund të ndërhyjë në bindjen e brendshme të gjyqtarit, në mënyrën e vlerësimit se si është ndërtuar ndërgjyqësia në një padi, apo në drejtim të disponimit të gjyqtarit mbi zgjidhjen e çështjes. Këto çështje mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet ankimit gjyqësor nga një gjykatë më e lartë. Nga ana tjetër evidentohet se neni 161, pika “ç” i K.Pr.Civile parashikon mundësinë e gjyqtarit për të disponuar mbi pushimin e gjykimit kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të paditurve nuk është e plotë, është parashikuar me ligjin nr.38/2017, datë 30.03.2017.
- Konstatimi i KPK-së në çështjen e përfunduar me vendimin nr.6603, datë 28.12.2015 (dosja 4) se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin gjyqësor “për rrëzimin pjesërisht të padisë lidhur me pagimin e kamatëvonesave” duke mos vlerësuar shkakun ligjor që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, sipas jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhet me vendimmarrjen e gjyqtares në lidhje me zgjidhjen në themel të çështjes, e cila është kompetencë ekskluzive e gjykatave më të larta. Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektesinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjiken e gjyqtarit që vlerësohet. Konkluzioni nëse gjykata e ka vlerësuar apo jo shkakun e padisë në tërësi mund të jepet vetëm nga një gjykatë më e lartë, në rastin konkret nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila në rastin konkret me vendimin nr. 48, datë 23.01.2020 rezulton se e ka lënë në fuqi vendimin nr.6603, datë 28.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm, si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Nivelin i vlerësimit	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj, si kur gjykon e vetme, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, nuk ka të dhëna për këtë tregues, pasi në çështjet e analizuara, nuk është administruar asnjë çështje për të cilën parashikohet afat ligjor gjykimi. Në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve administrative të themelit ose kërkesave pa palë kundërshtare, përveç parashikimeve të afatit ligjor të gjykimit për kërkesa të posaçme të tilla si: kërkesa për sigurimin e padisë për të cilën neni 28, pika 3 i ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin 5 ditor të shqyrtimit apo çështje të tjera administrative të cilat, sipas ligjeve të posaçme, duhet të shqyrtohen brenda një afati të përcaktuar.

Nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe çështjeve të administruar për shkak të ankesave, referuar kategorisë së çështjeve, nuk rezulton që për shqyrtimin e tyre, ligji të ketë parashikuar afat ligjor shqyrtimi.

KONKLUZIONI

Pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi dhe nga dokumentet e përdorura gjatë procesit të vlerësimit nuk ka të dhëna të tjera që mund të vlerësohen në drejtim të këtij treguesi, do të prezumohet se gjyqtarja i ka gjykuar të gjitha çështjet për të cilat parashikohet afat ligjor, brenda këtij të fundit. Gjithsesi, rezulton se ajo ka respektuar të gjitha afatet procedurale të parashikuara nga ligji 49/2012 për kryerjen e veprimeve për administrimin e procesit dhe për këtë arsye, vlerësoj se aftësia e gjyqtares në lidhje me këtë tregues, duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi mbështetur në burimet e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna për çështje të shqyrtuara jashtë afatit ligjor dhe ka respektuar në çdo rast afatet procedurale të parashikuara në ligj për kryerjen e veprimeve të caktuara.*

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtare {...} ka qenë në intervale kohore nga 1 muaj e 14 ditë (shih dosjen 5) deri në 2 muaj e 19 ditë (shih dosjen 4). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 16 ditë (shih dosjen 1), 2 muaj e 5 ditë (shih dosjen 2) dhe 1 muaj e 25 ditë (shih dosjen 3). Vendimi i KLD-së nr.261/2, datë 14.04.2010 parashikon që gjykimet administrative duhet të përfundojnë brenda një muaji nga regjistrimi i tyre në gjykatë (neni 5 shkronja “c” e aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”. Rezultoi se afati standard 1 mujor është tejkaluar në të pesta rastet e përzgjedhura me short. (shih dosjet 1, 2, 3, 4 dhe 5)... Në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuarës në asnjë rast, nuk janë shkelur afatet për vënien në lëvizje të çështjes, për kryerjen e veprimeve përgatitore të parashikuara nga neni 25 i ligjit nr.4/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short dhe çështjes të referuar nga ish/Inspektorati i KLD-së për tu mbajtur parasysh për efekt të vlerësimit etik

dhe profesional, pa përfshirë 3 (tre) vendimet e zgjedhura nga gjyqtarja në kushtet kur në ekstremitetet e vendimit nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Për 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 1 (një) çështje të referuar për kohëzgjatjen e gjykimit, nga verifikimi i ankesave, rezulton se gjykimi ka zgjatur më tepër se standardi minimal kohor 1/muaj, sipas vendimit nr.261/2 të KLD. Kryesisht çështjet kanë përfunduar brenda afateve nga 31 ditë minimalisht deri në 345 ditë. Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit në 11 dosjet e përzgjedhura me short është rreth 53 ditë ose 1 muaj e 23 ditë dhe në çështjen e administruar të referuar për shkak të ankesave gjykimi ka zgjatur 345 ditë ose 11 muaj e 15 ditë.

Në çështjen e referuar për vlerësim etik dhe profesional, për shkak të kohëzgjatjes së gjykimit, rezulton se çështja administrative e përfunduar me vendimin nr.228, datë 26.01.2016, gjykimi ka përfunduar për 345 ditë ose 11 muaj e 15 ditë. Në kohëzgjatjen e gjykimit të kësaj çështje rezulton të ketë ndikuar edhe periudha e pezullimit të gjykimit deri në përfundim të shqyrtimit nga Gjykata e Lartë të ankimit të veçantë të paraqitur nga pala e paditur lidhur me vendimin e ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit. Konkretisht, rezulton se çështja ka qenë e pezulluar për periudhën 31.03.2015-22.09.2015, pra për 175 ditë ose 5 muaj e 25 ditë. Duke zbritur periudhën në të cilën çështja ka qenë e pezulluar, atëherë kohëzgjatja e gjykimit për këtë çështje do të rezultonte 170 ditë ose 5 muaj e 20 ditë.

Në total, për 12 çështjet e analizuar, koha mesatare e përfundimit të gjykimit rezulton të jetë rreth 63 ditë ose 2 muaj e 3 ditë.

Duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve për të cilat gjykimi ka përfunduar tej standardit minimal kohor, në raport me numrin e çështjeve të analizuar, rezulton se të gjitha çështjet janë përfunduar tej këtij afati, duke e tejkalluar nga disa ditë deri në disa muaj në disa çështje.

Në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve administrative të themelit ose kërkesave pa palë kundërshtare, përveç parashikimeve të afatit ligjor të gjykimit për kërkesa të posaçme të tilla si: kërkesa për sigurimin e padisë, për të cilën neni 28, pika 3, i ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin 5 ditor të shqyrtimit apo çështje të tjera administrative të cilat, sipas ligjeve të posaçme, duhet të shqyrtohen brenda një afati të përcaktuar.

Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, parashikon afate për kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Duke iu referuar parashikimeve të nenit 25, të ligjit nr.49/2012, në të cilin parashikohet afati 7 ditor për kryerjen e veprimeve paraprake, afatit maksimal 10 ditor për plotësimin e të metave të padisë për paditësin, afatit maksimal 10 ditor për depozitimin e prapësimeve me shkrim dhe provave nga pala e paditur, afatit maksimal 20 ditor për kryerjen e ekspertimit në rast se vlerësohet i nevojshëm, afatit minimal 5 ditor për njoftimin e palëve për kryerjen e veprimeve si më sipër, rezulton se veprimet përgatitore që duhet të kryejë gjyqtari në një çështje administrative me palë zgjatin mesatarisht 47 ditë.

Nëse do të zhvillohet seancë përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, pas përfundimit të veprimeve përgatitore sipas nenit 25 të ligjit nr.49/2012, bashkë me kohën minimale të nevojshme për realizimin e njoftimeve të palëve, kjo fazë e gjykimit zgjat 15 ditë.

Pas zhvillimit të seancës përgatitore, çaktimi i seancës gjyqësore, në referim të nenit 27, pika 1 të ligjit nr. 49/2012, duhet të jetë brenda afatit ligjor 15 ditor. Në rast se procesi gjyqësor do të zhvillohet brenda një seancë gjyqësore dhe nuk do të ketë kërkesa të palëve për shtyrje të gjykimit, kryerjen e veprimeve të tjera procedurale që do të pasjellin shtyrje të seancës, duke marrë parasysh vetëm afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 302 i K.Pr.Civile për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve dhe afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 308 të K.Pr.Civile për shpalljen e vendimit të arsyetuar nga gjykata, kohëzgjatja e gjykimit nga momenti i përfundimit të seancës përgatitore deri në shpalljen e vendimit do të ishte minimalisht 25 ditë.

Në tërësi, duke iu referuar afateve për zhvillimin e veprimeve procedurale si më sipër, gjykimi i një çështje administrative do të përfundonte brenda një afati minimal prej 87 ditësh ose rreth 3 muaj. Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, duke respektuar të gjitha hapat proceduralë të domosdoshëm për zhvillimit e gjykimit, si dhe duke respektuar me rigorozitet afatet procedurale për kryerjen e tyre, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor orientues ende në fuqi.

Në këtë rast, respektimi strikt i afateve të parashikuara nga ligji nr.49/2012 dhe Kodi i Procedurës Civile, sjell një kohëzgjatje gjykimi të çështjeve më shumë se 1 muaj nga ajo e përcaktuar si standard orientues, e si i tillë ky i fundit nuk ka kuptim të gjejë zbatim.

Referuar afatit 87 ditor, të llogaritur më lart, si kohë e domosdoshme për kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme, rezulton se nga 12 çështje të analizuara, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, sipas një llogaritje vetëm matematikore, vetëm 1 prej tyre, **ose 8.3% e çështjeve**, kanë përfunduar përtej këtij afati.

Në vlerësimin e këtij treguesi mbahet parasysh fakti që standardi minimal kohor 1 muaj për gjykimet administrative është përcaktuar në vitin 2010 ndërkohë që legjislacioni i posaçëm për gjykimet administrative është miratuar dy vite më vonë, duke parashikuar afate për kryerjen e veprimeve procedurale nga ana e gjykatës, respektimi me rigorozitet i të cilave, e bën të vështirë respektimin e standardit minimal kohor në fuqi për kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve administrative. Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji rezulton të jenë zbatuar me rigorozitet nga gjyqtarja në të gjitha çështjet e vëzhguara, pavarësisht faktit se standardi minimal kohor në fuqi nuk është respektuar në dukje.

Në tërësi, duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 1 çështje të referuara për vlerësim etik dhe profesional për kohëzgjatjen e gjykimit nga Inspektorati i KLD-së, mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për të gjitha çështjet, rezulton të jetë rreth 63 ditë ose 2 muaj e 3 ditë, më i ulët se afati 87 ditor i kohëzgjatjes së gjykimit sipas arsyetimit të mësipërm.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

- a) afatin e gjykimit të çështjeve administrative për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, duke pranuar si të tillë atë 87 ditor dhe jo 1 muaj;
- b) raportit të çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet ky afat, i cili rezulton të jetë në masën 8.3%;
- c) mesatares së kohëzgjatjes së gjykimit për të gjitha çështjet, e cila rezulton të jetë rreth 63 ditë ose 2 muaj e 3 ditë;

vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin "Plotësimi i standardeve minimale kohore" gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga tre kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykatat administrative (*administrative me palë kundërshtarë, marrëdhënie pune dhe administrative pa palë kundërshtarë*). Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short, si dhe të dhënave për çështjen e referuar për vlerësim etik dhe profesional, pas verifikimit të ankesës, pa përfshirë vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja, në kushtet kur në ekstremitetet e vendimit nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje në raport me standardin minimal kohor 1 muaj, sipas kategorisë së çështjeve (*të gjitha çështjet janë çështje administrative me palë kundërshtarë ose marrëdhënie pune*), rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është e përafërt ose më e gjatë se standardi minimal kohor për secilën nga dy kategoritë të cilave i përkasin çështjet e analizuara.

Konkretisht :

- (i) për kategorinë çështje “Administrative me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, duke iu referuar kohëzgjatjes së 7 çështjeve të kësaj kategorie, rezulton të jetë 2 muaj e 16 ditë (76 ditë), më e gjatë se standardi minimal kohor në fuqi për këtë kategori;
- (ii) për kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, duke iu referuar kohëzgjatjes së 5 çështjeve që i përkasin kësaj kategorie, rezulton të jetë 1 muaj e 14 ditë (44 ditë), më e gjatë se standardi minimal kohor në fuqi për këtë kategori çështjesh.

Duke iu referuar arsyetimit të mësipërm lidhur me standardin minimal që duhet të gjejë zbatim për gjykimin e të gjitha çështjeve administrative, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të dy kategoritë e çështjeve për të cilat ka të dhëna, rezulton si më poshtë:

- (i) për kategorinë çështje “Administrative me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, duke iu referuar kohëzgjatjes së 7 çështjeve të kësaj kategorie, rezulton të jetë 2 muaj e 16 ditë (76 ditë), më e shkurtër se afati 87 ditor, i pranuar si standard minimal kohor.
- (ii) për kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, duke iu referuar kohëzgjatjes së 5 çështjeve që i përkasin kësaj kategorie, rezulton të jetë 1 muaj e 14 ditë (44 ditë), më e shkurtër se afati 87 ditor, i pranuar si standard minimal kohor.

Për sa më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të dy kategoritë për të cilat ka të dhëna, me afatin 87 ditor të pranuar si një standard minimal për një gjykim administrativ, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve.

KONKLUZIONI

Mbështetur në të njëjtën analizë si treguesi më sipër (treguesi “2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.”), duke konsideruar afatin 87 ditor si standard minimal kohor për efekte të krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje, rezulton se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është e lartë, pasi për të gjitha kategoritë e çështjeve, koha mesatare është më e shkurtër se standardi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për gjykimin administrativ, për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar.
-

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: "...Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këtë të dhëna është 92.7 %".

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :**

Nga të dhënat statistikore të administruara në dosje, për periudhën e vlerësimit të përbërë nga 4 vite kalendarike, dy prej të cilëve janë jo të plotë, rezulton gjyqtarja ka gjykuar në total 1498 çështje për një periudhë të ushtrimit të detyrës prej 36 muajsh, ndërkohë që i janë caktuar për gjykim gjatë kësaj periudhe 1562 çështje, të ndara sipas viteve, si më poshtë:

- (i) **Për vitin 2013** (01.01.2013-01.11.2013), në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë i janë caktuar për gjykim 269 çështje, nga të cilat 244 çështje civile dhe 25 çështje penale. Ka përfunduar gjykimin për 345 çështje, nga të cilat 305 civile dhe 40 penale.
- (ii) **Për vitin 2014** (01.12.2014-31.12.2014), i janë caktuar për gjykim 23 çështje, nga të cilat 17 çështje themeli dhe 6 kërkesa. Ka përfunduar 6 kërkesa dhe ka mbartur për vitin tjetër 17 çështje.
- (iii) **Për vitin 2015** (01.01.2015-31.12.2015), i janë caktuar për gjykim 610 çështje, nga të cilat 446 çështje themeli dhe 164 kërkesa. Ka përfunduar 551 çështje nga të cilat 391 themeli dhe 160 kërkesa dhe ka mbartur për vitin tjetër 76 çështje.
- (iv) **Për vitin 2016** (01.01.2016-07.10.2016), i janë caktuar për gjykim 660 çështje, nga të cilat 459 çështje themeli dhe 201 kërkesa. Ka përfunduar 596 çështje nga të cilat 395 themeli dhe 201 kërkesa dhe nuk rezultojnë çështje të mbartura.

Duke konsideruar faktin që në vitin 2014⁵⁵ gjyqtarja ka ushtruar detyrën për vetëm 19 ditë, treguesit statistikorë për këtë periudhë nuk mund të japin të dhëna të sakta për treguesin e rendimentit, duke qenë se gjyqtarja ka filluar punë në fund të vitit (*në fillim të muajt dhjetor*).⁵⁶ Për rrjedhojë, çështjet e caktuara nuk mund të përfundonin për një periudhë kohore të barabartë me 19 ditë, kohë kjo e barabartë ose më e shkurtër se afatet ligjore për disa çështje dhe më e shkurtër se standardi minimal kohor për kategoritë e çështjeve administrative. Rrjedhimisht, treguesit e vitit 2014 nuk mund të merren në konsideratë në përlllogaritjen e rendimentit të përfundimit të çështjeve dhe kjo përlllogaritje do të bëhet mbi të dhënat statistikore për tre vitet me të paktën 6 muaj ushtrimi të veprimtarisë (2013, 2015 dhe 2016).

Duke iu referuar numrit të çështjeve të përfunduara, me ato të caktuara për secilin vit, rezulton se:

- *Për vitin 2013*, gjyqtarës i janë caktuar 269 çështje dhe ka përfunduar 345 çështje. Për pasojë rendimenti i përfundimit të çështjeve është rreth 128%;
- *Për vitin 2015*, gjyqtarës i janë caktuar 610 çështje dhe ka përfunduar 551 çështje. Për pasojë rendimenti i përfundimit të çështjeve është rreth 90%;
- *Për vitin 2016*, gjyqtarës i janë caktuar 660 çështje dhe ka përfunduar 596 çështje. Për pasojë rendimenti i përfundimit të çështjeve është rreth 90%;

⁵⁵Për periudhën nëntor 2013-tetor 2014 gjyqtarja ka qenë me leje barrë lindje dhe për pasojë nuk e ka ushtruar detyrën.

⁵⁶Referuar vërtetimit nr.773 prot, datë 24.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë rezulton se gjyqtarës i janë caktuar çështje me short në fillim të muajt dhjetor, në datë 12.12.2014. Vërtetimi ndodhet në faqen 16 e dosjes së rivlerësimit

Për të tre vitet së bashku rendimenti i përfundimit të çështjeve si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1492 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (1539 çështje), **është 97%**.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 97%. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 8 pikë. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli”*. Bazuar në këtë parashikim dhe në analizën statistikore si më sipër, rezulton se gjyqtarja (i) për vitin 2015 ka përfunduar 391 çështje me palë kundërshtare, ose rreth 160% më shumë se standardi sasior të punës; (ii) për vitin 2016 (deri në 08.10.2016) ka përfunduar 395 çështje me palë kundërshtare, ose 237% më shumë se standardit sasior të punës (duke llogaritur për periudhën 9 mujore), vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që rezulton nga të dhënat statistikore.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër në lidhje me treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja duhet të pikëzohet me 10 pikë.*

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar.

Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 1 (një) çështje të referuar për kohën e arsyetimit të vendimit gjyqësore, nga verifikimi i ankesave.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsytimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja {...}, përgjithësisht mund të thuhet, se i ka kushtuar rendësi arsytimit në kohë të vendimeve gjyqësore, pavarësisht ngarkesës së lartë sasiore që ajo ka patur. Në 2 raste, vendimi është arsyetuar në respektim të afati ligjor 7 ditor të parashikuar nga neni 42/3 i ligjit nr.49.2012. Në dy raste të tjera, afati ligjor është tejkaluar me vetëm një ditë dhe vetëm në një rast afati ligjor është tejkaluar me 7 ditë. Konkretisht, arsytimi i vendimit është kryer për 14 ditë nga shpallja (shih dosjen 1), për 8 ditë nga shpallja (shih dosjet 2 e 3), për 2 ditë nga shpallja (shih dosjen 4) dhe për 4 ditë nga shpallja (shih dosjen 5)”*.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Sipas informacionit të përpunuar në raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit, për 5 dosjet e përzgjedhura në kuadër të këtij procesi, rezulton se :

- (i) Dosja që i përket vendimit me nr.1103, datë 04.03.2015 (administrative) është dorëzuar në datën 18.03.2015, 14 ditë nga data e shpalljes së vendimit;
- (ii) Dosja që i përket vendimit me nr.1540, datë 24.03.2015 (administrative) është dorëzuar në datën 01.04.2015, 8 ditë nga data e shpalljes së vendimit;
- (iii) Dosja që i përket vendimit me nr.2548, datë 12.05.2015 (marrëdhënie pune) është dorëzuar në datën 20.05.2015, 8 ditë nga data e shpalljes së vendimit;
- (iv) Dosja që i përket vendimit me nr.6603, datë 28.12.2015 (administrative) është dorëzuar në datën 30.12.2015, 2 ditë nga data e shpalljes së vendimit;
- (v) Dosja që i përket vendimit me nr.2622, datë 26.05.2016 (marrëdhënie pune) është dorëzuar në datën 30.05.2016, 4 ditë nga data e shpalljes së vendimit;

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, së bashku me fletët e regjistrit të dorëzimit të dosjeve, për 6 çështjet e përzgjedhura rishtazi, rezulton se:

- (vi) Dosja që i përket vendimit me nr.1137, datë 05.03.2015 (administrative) është dorëzuar në datën 18.03.2015, 13 ditë nga data e shpalljes së vendimit;
- (vii) Dosja që i përket vendimit me nr.1300, datë 12.03.2015 (marrëdhënie pune) është dorëzuar në datën 20.03.2015, 8 ditë nga data e shpalljes së vendimit;
- (viii) Dosja që i përket vendimit me nr. 3336, datë 27.06.2016 (administrative) është dorëzuar në datën 04.07.2016, 7 ditë nga data e shpalljes së vendimit;
- (ix) Dosja që i përket vendimit me nr.4435, datë 03.10.2016 (marrëdhënie pune) është dorëzuar në datën 04.10.2016, 1 ditë nga data e shpalljes së vendimit;
- (x) Dosja që i përket vendimit me nr.3090, datë 16.06.2016 (administrative) është dorëzuar në datën 22.06.2016, 6 ditë nga data e shpalljes së vendimit;
- (xi) Dosja që i përket vendimit me nr.2230, datë 09.05.2016 (marrëdhënie pune) është dorëzuar në datën 19.05.2016, 10 ditë nga data e shpalljes së vendimit;
- (xii) Në relacionin e datës 23.03.2016, të Inspektoratit të KLD, objekt verifikimi dhe analize ka qenë respektimi i afatit ligjor, lidhur me dorëzimin e vendimit nr. 4848, datë 05.10.2015 (administrative) nga gjyqtarja {...}, ku ka rezultuar se vendimi është dorëzuar nga gjyqtarja në datën 14.10.2015, 9 ditë nga shpallja e vendimit.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit:

- (i) për kategorinë “Administrative me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 8 ditë, tejkalimi i afatit procedural 7 ditor, i parashikuar në nenin 42/3 të ligjit 49/2012, është me vetëm 1 ditë, një tregues ky i pakonsiderueshëm, duke konsideruar që në përlllogaritje kanë ndikuar edhe pushimet javore;
- (ii) për kategorinë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 6 ditë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar vlerësoj se klasifikohet si “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategorive të çështjeve*”. Pavarësisht analizës matematikore, referuar asaj logjike ku vlerësuesi mban në konsideratë afatin 1 ditor të tejkalimit, faktin se ky tejkalim konsiderohet i papërfillshëm, duke pasur në konsideratë se në përlllogaritje kanë ndikuar edhe pushimet javore, si dhe tejkalimi konstatohet vetëm në një kategori çështjesh, referuar edhe ngarkesës në punë të gjyqtarës, duke aplikuar koeficientin 20% të rritjes me 1 shkallë pikëzimi, për këtë kriter gjyqtarja duhet të pikëzohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JOPRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 2 seanca (dosja 1 dhe 5), me 4 seanca (shih dosjet 2 dhe 3) dhe me 5 seanca (shih dosjen 4). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 17 seanca gjyqësore, nga të vetëm një seancë ka qënë joproduktive. Shkak për dështimin e një seance të vetme, ishte rënia e saj në ditë feste zyrtare, e cila ishte ditë pushimi (Festa e Pashkëve Katolike). Gjashtëmbëdhjetë seancat e tjera të vëzhguara ishin të gjitha produktive”.

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:**

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve me palë kundërshtare (*çështje administrative me palë kundërshtare dhe marrëdhënie pune*), lidhur me numrin e seancave gjyqësore, rezulton si më poshtë:

Në çështjet e përzgjedhura me short administruar në dosjen e rivlerësimit:

- (i) Çështja që i përket vendimit me nr.1103, datë 04.03.2015 (administrative), për gjykimin e saj janë zhvilluar 2 seanca, 1 seancë përgatitore dhe **1 seancë gjyqësore**. Nuk ka seanca jo produktive.
- (ii) Çështja që i përket vendimit me nr.1540, datë 24.03.2015 (administrative), për gjykimin e saj janë zhvilluar 4 seanca, 1 seanca përgatitore dhe **3 seanca gjyqësore**. Nuk ka seanca joproduktive, seanca e parë gjyqësore është shtyrë për t'i komunikuar palës së paditur ndryshimin e objektit të padisë, sipas parashikimeve të nenit 185 të K.Pr.Civile dhe seanca e dytë është për t'i dhënë palëve kohë për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim.
- (iii) Çështja që i përket vendimit me nr.2548, datë 12.05.2015 (marrëdhënie pune), për gjykimin e saj janë zhvilluar 4 seanca, 2 seanca përgatitore dhe **2 seanca gjyqësore**. Një seancë përgatitore nuk është zhvilluar për shkak se data e planifikuar ishte ditë pushimi zyrtar, ndërsa seanca gjyqësore është shtyrë për t'i dhënë palëve kohë për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim.
- (iv) Çështja që i përket vendimit me nr.6603, datë 28.12.2015 (administrative), për gjykimin e saj janë zhvilluar 5 seanca, 3 seanca përgatitore dhe **2 seanca gjyqësore**. Seanca e parë përgatitore është shtyrë për t'i lënë kohë palës paditëse për të përgatitur pyetjet me shkrim për ekspertin, seanca e dytë përgatitore është shtyrë për t'i lënë kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit dhe seanca e parë gjyqësore është shtyrë për t'i dhënë palëve kohë për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim.
- (v) Çështja që i përket vendimit me nr.2622, datë 26.05.2016 (marrëdhënie pune), për gjykimin e saj janë zhvilluar 2 seanca, 1 seancë përgatitore dhe **1 seancë gjyqësore**. Nuk ka seanca jo produktive.

Në çështjet e përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit:

- (vi) Çështja që i përket vendimit me nr.1137, datë 05.03.2015 (administrative), për gjykimin e saj janë zhvilluar 2 seanca, 1 seancë përgatitore dhe **1 seancë gjyqësore**. Nuk ka seanca jo produktive.
- (vii) Çështja që i përket vendimit me nr.1300, datë 12.03.2015 (marrëdhënie pune), për gjykimin e saj janë zhvilluar 4 seanca, 2 seanca përgatitore dhe **2 seanca gjyqësore**. Seanca e para përgatitore është shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarës për arsye shëndetësore.
- (viii) Çështja që i përket vendimit me nr.3336, datë 27.06.2016 (administrative), për gjykimin e saj janë zhvilluar 5 seanca, 1 seancë përgatitore dhe **4 seanca gjyqësore**. Nuk ka seanca joproduktive.
- (ix) Çështja që i përket vendimit me nr.4435, datë 03.10.2016 (marrëdhënie pune), për gjykimin e saj janë zhvilluar 3 seanca, nga të cilat 1 seancë përgatitore dhe **2 seanca gjyqësore**. Seanca e parë gjyqësore është shtyrë për shpalljen e vendimit të arsyetuar.
- (x) Çështja që i përket vendimit me nr.3090, datë 16.06.2016 (administrative), për gjykimin e saj janë zhvilluar 2 seanca, nga të cilat 1 seancë përgatitore dhe **1 seancë gjyqësore**.
- (xi) Çështja që i përket vendimit me nr.2230, datë 09.05.2016 (marrëdhënie pune), për gjykimin e saj janë zhvilluar 2 seanca, nga të cilat 1 seancë përgatitore dhe **1 seancë gjyqësore**.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në çështjet e vëzhguara varion nga 1 deri në 4 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 11 çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 2 seanca.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave gjyqësore joproductive, rezulton se gjyqtarja ka mbikëqyrur dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët. Konstatohet se nga ana e gjyqtarës merren të gjitha masat me qëllim shmangien e seancave joproductive dhe numri mesatar i seancave në masën 2, vjen për shkak të respektimit të detyrimit ligjor për t'i komunikuar palës së paditur në mungesë ndryshimin e objektit të padisë apo për dhënien e kohës palëve për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare.

KONKLUZIONI

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 11 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është **2 seanca** dhe gjyqtarja në të gjitha çështjet ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave gjyqësore joproductive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 2 seanca dhe gjyqtarja ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Gjyqtarja {...}, ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore. Ajo respekton afatin ligjor 7 ditor për vënien në lëvizje të dosjes dhe kryen me korrektësi veprimet përgatitore të përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr.49/2012, kur vlerëson se padia nuk ka të meta, i njofton të paditurit aktet dhe i cakton afat atij për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, aktet e paraqitura prej të paditurit ia njofton paditësit, zhvillon seancë përgatitore me praninë e palëve dhe kur vlerëson se aktet janë të plota e kalon çështjen për gjykim. Duke i kushtuar rëndësi veprimeve përgatitore, ajo e përfundon gjykimin me 1-3 seanca gjyqësore. I kushton rëndësi edhe dokumentimit të veprimeve të kryera, si dhe shprehet me urdhra dhe vendime të ndërmjetme mbi kërkesat e palëve. Ndjek me rigorozitet radhën e veprimeve procedurale, siç përcaktohet nga ligji, gjer në shpalljen e vendimit përfundimtar*”.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve me palë kundërshtare (*çështje administrative me palë kundërshtare dhe çështje gjyqësore marrëdhënie pune*), lidhur me kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, rezulton si më poshtë:

Gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke zhvilluar veprimet përgatitore në dhomë këshillimi brenda një kohë shumë të shkurtër nga caktimi i tyre me short, në çdo rast brenda afatit ligjor 7 ditor nga data e shortit, në përputhje me parashikimet e nenit 25 pika 1 të ligjit nr.48/2012. Në 11 dosjet e vëzhguara rezulton se seanca e parë për kryerjen e veprimeve përgatitore është zhvilluar nga 1 ditë deri në 6 ditë pas caktimit me short.

Në veprimet përgatitore të zhvilluara pas caktimit të çështjeve me short, gjyqtarja kryen me korrektësi dhe në mënyrë të plotë veprimet procedurale të parashikuara në nenin 25, pika 1 të ligjit nr.49/2012, vlerëson nevojën ose jo të ekspertimit, disponon për njoftimin e padisë dhe akteve palës së paditur dhe kur është rasti edhe të Avokaturës së Shtetit, bashkë me njoftimin për paraqitjen e tyre brenda afati ligjor 10 ditor duke shoqëruar disponimin e gjykatës dhe njoftimin e palës me paralajmërimin për mospranimin e tyre në rast të mosparaqitjes në afat, në respektim të parashikimeve të nenit 25, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 49/2012. Pas kalimit të afatit për paraqitjen nga pala e paditur të prapësimeve me shkrim të provave, gjyqtarja disponon për caktimin e seancës përgatitore duke evidentuar shkakun për caktimin e seancës përgatitore. Në dosjet e vëzhguara në çdo rast është vlerësuar nevoja për zhvillimin e seancës përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

Seancat përgatitore janë zhvilluar në mënyrë korrekte dhe të plotë duke evidentuar në çdo rast verifikimin e paraqitjes së palëve, relatimin lidhur me aktet e njoftimit të palëve dhe paraqitjen ose jo të tyre. Pas zhvillimit të veprimeve të përcaktuara në nenin 158/b të K.Pr.Civile, ka disponuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore e cila në çdo rast, në 11 dosjet e vëzhguara është caktuar brenda afatit ligjor 15 ditor të parashikuar në nenin 27, pika 1 të ligjit nr. 49/2012. Urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, pasqyruar në procesverbalin e seancës përgatitore, përmban elementët e përcaktuar në nenin 27, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, si dhe paralajmërimin për pasojat e mosparaqitjes së provave para zhvillimit të seancës së parë gjyqësore, sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 3 të ligjit nr.39/2012.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur në mënyrë manuale ose me regjistrim audio, pasi ky sistem është vënë në funksionim në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre; relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni për palët që nuk janë paraqitur; disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura; shpalljen e gjykatës; dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake; disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla; deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave; administrimin e provave; drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat; dhënien fjalën palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat; deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor; disponimin me vendim për kërkesat e palëve për

përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë përgjithësisht të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe, kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes (*në rastet e disponimit për kërkesat e palëve lidhur me saktësimin e objektit të padisë, shtyrjen e seancës, etj.*).

Në dosjet e vëzhguara seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesa të papërfillshme që shkojnë nga 5 deri në 12 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësi shumë të lartë në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në veprimet përgatitore, seancat përgatitore, dhe seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtares për treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” dukë u pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“...Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale”.*

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur përgjithësisht rendin kronologjik të paraqitjes së akteve, ndërthurur me veprimet procedurale të gjykatës, sipas kohës së zhvillimit të tyre. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë duke filluar me aktin e shortit, kërkesëpadinë dhe provat e paraqitura nga pala paditëse, prapësimet dhe provat e paraqitura nga pala e paditur (kur prapësimet janë paraqitur me shkrim), kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave të veprimeve paraprake, aktet e njoftimit, seancave përgatitore dhe gjyqësore, vendimin gjyqësor përfundimtar. Mënyra e renditjes së akteve në dosje e bën atë të shfrytëzueshme pa vështirësi nga subjektet dhe gjykata më e lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa vështirësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet gjyqësore dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja {...}, ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadi, procesverbali i veprimeve përgatitore në dhomë këshillimi, procesverbali i seancave përgatitore, apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat, konkluzionet me shkrim të palëve, vendimi përfundimtar, ankimi i palëve nëse ka, vendimi i gjykatave më të larta etj...”*

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e paraqitura nga palët (padi, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet e palëve kur ato janë paraqitur me shkrim), aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seancë të zhvilluar në dhomë

këshillimi, seancë përgatitore dhe gjyqësore, vendimet gjyqësore, procesverbali audio kur seancat janë zhvilluar me sistem audio).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Në tërësi, dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë, nuk konstatohen mungesa aktesh dhe nuk konstatohet në dosje dokumentacion i cili nuk i përket çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, duhet të vlerësohet “Shumë e lartë” pikëzohet me 10 pikë.

Nivelin i vlerësimit	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale konkludohet se: “...Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës {...} (shih të dhënat nga Burimet Arkivore të KLGJ-së). Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt”.

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Nga aktet e dosjes së rivlerësimit, rezulton se në të nuk janë administruar aktet lidhur me verifikimin e ankesave. Për këtë arsye, u administruan nga arkiva e KLGJ, aktet përkatëse për verifikimin e secilës ankesë. Nga administrimi i tyre rezulton se, pas trajtimit, ankesat janë arkivuar dhe vetëm 2 (dy) prej tyre, përmbajnë të dhëna që përbëjnë burim vlerësimi e që janë analizuar në kriterin e “Aftësive Organizative” të gjyqtares.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD, trajtuar gjerësisht në pjesën e parë të këtij projektraporti, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtares.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.665, datë 25.05.2023 rezulton se për subjektin e rivlerësimit {...} janë paraqitur disa denoncime, nga të cilat, për 8 prej tyre i janë kërkuar shpjegime subjektit. Pas verifikimit, KPK ka konkluduar lidhur me secilin prej tyre, duke i shqyrtuar dhe trajtuar në kuadër të vlerësimit profesional, por nuk rezultojnë të jenë verifikuar apo trajtuar çështje që mund të ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, në drejtim të etikës së saj në punë.

Në tërësi, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin e gjyqtares.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale konkludohet se: “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në ish-Inspektoratin e KLD-së, gjatë periudhës së rivlerësimit profesional 08.10.2013-08.10.2016, nuk rezultoi të jenë regjistruar ankesa, ku të vihet në dyshim integriteti i gjyqtares {...}”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Vendimi nr. 665, datë 25.05.2023 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Lidhur me rezultatet e trajtimit të ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 665, datë 25.05.2023, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë për gjyqtaren {...} konkludohet se: “13.6 Në përfundim, bazuar në sa më lart për të gjitha pasuritë e deklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur (ish-bashkëjetuesit), trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin të përfundimin se subjekti i rivlerësimit {...} ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, duke pasur parasysh se mungesa e burimeve të ligjshme në vlerën totale prej 604.841 lekësh, në vitin 2015, për blerjen e dy automjeteve, e vetme, nuk mund të përbëjnë shkak të mjaftueshëm për të dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. 13.7. Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit {...} ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë”.

Lidhur me kriterin e figurës, në këtë vendim, konkludohet se: “6. Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës”.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtares.

***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” aftësia e gjyqtares vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale konkludohet se: “Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për vetë subjektin e rivlerësimit, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupimeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjekti të rivlerësimit”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në 3 (tre) vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe aktet e 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër aftësia e gjyqtares për treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se: *“Për vetë subjektin e rivlerësimit, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve”.*

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtares, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares në periudhën e vlerësimit. Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares.

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, konkludohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares duhet të jetë i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares vlerësohet “I pakonsiderueshëm” duke u pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale konkludohet se: “Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor, por edhe në ato procese ku është realizuar regjistrimi i seancave audio, është konstatuar se gjyqtarja {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”.

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar.

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Referuar vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre dhe në çdo rast duke respektuar normat e komunikimit zyrtar dhe etik.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave përgatitore dhe gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në përpilimin e akteve procedurale.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Referuar 3 (tre) vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale konkludohet se: “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike, mbi aftësinë e subjektit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk është evidentuar asnjë rast, që të ketë patur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, dështim të seancave të planifikuara apo vonesa të dukshme në arsyetimin e vendimeve, gjë që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi, si dhe prezumimit se ky komunikim është në nivel të lartë, për shkak të mungesës së ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të

drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga te burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe faktit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën të bashkëpunimit, pas sjell si pasojë prezumimin se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera te vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivelin të lartë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale konkludohet se: “Gjyqtare {...} i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 7 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (shih të dhënat tek Trajnimet në 3 vitet e fundit) për një periudhë trevjeçare. Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 11 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit administrativ. Për tu theksuar është fakti që znj. {...}, ka ndjekur trajnimet në Shkollën e Magjistraturës vetëm në një periudhë dyvjeçare të rivlerësimit kalimtar, pasi për një periudhë njëvjeçare (11/2013-10/2014) ajo ka qenë me leje të barrë lindjes. Së fundi, znj. {...} , i ka kushtuar interes edhe pjesëmarrjes në trajnime jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, ku temat e trajnimit kanë patur ndikim dhe lidhje me detyrën e saj si gjyqtare administrative”.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Referuar vërtetimit me nr.524/1 prot, datë 20.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës, rezultojnë se gjyqtarja, gjatë periudhës së vlerësimit ka qenë pjesëmarrëse në 7 aktivitete trajnuese pjesë e programit të trajnimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë zhvilluar gjithsej në **10 ditë trajnimi**.

Rezultojnë gjithashtu se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnim jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, i cili rezultojnë të jetë aktivitet i formimit profesional, si dhe aktivitetet ndërinstitucional. Konkretisht, rezultojnë se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnimin jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës:

- (i) me temë “*Sanksionet komunitare dhe alternativat e dënimit me burgim*”, trajnimi online i organizuar nga Këshilli i Europës, organizata HELP certifikuar në datën 31.12.2013;⁵⁷
- (ii) me temë “*Hyrje në gjykimin administrativ në Gjermani*”, organizuar nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar në datat 28-29 shtator 2016;
- (iii) me temë “*Mbrojtja e migruesve, azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri duke u fokusuar në nenin 3, 5 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*”, organizuar në datën 16 nëntor 2016, nga Këshilli i Europës dhe UNHCR;⁵⁸
- (iv) me temë “*Ligji i ri për të drejtën e autorit*”, organizuar në datën 7 dhjetor 2016, nga Dhoma Amerikane e Tregtisë.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, ligji nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese apo kohëzgjatjen minimale të këtij angazhimi. Ndërkohë, ky detyrim parashikohej në nenin 23 të ligjit nr.8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit *gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.*

Aktualisht, në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti, si dhe gjatë pesë viteve.⁵⁹ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij, të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij, që tregojnë ngritjen profesionale. Referuar sa më sipër, pavarësisht se ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit e miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk kanë qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e

⁵⁷Certifikata e trajnimit në faqen 25 të dosjes së rivlerësimit

⁵⁸Certifikata e trajnimit në faqen 26 të dosjes së rivlerësimit

⁵⁹Në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se: “1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t’u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë: a) të përshtatshme për funksionin e tij; b) të organizuara dhe certifikuar nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit.”

vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrjeje.

Sa më sipër, rezulton se znj. {...}, ka marrë pjesë në 11 (njëmbëdhjetë) aktivitete të formimit profesional të llojit trajnime dhe seminare, brenda dhe jashtë programit të formimit vazhdues, të cilat kanë zgjatur në **total 15 ditë**.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtarës në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë 20 pikë, meqenëse për periudhën 3 vjeçare rezulton pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 10 ditë trajnimi dhe pjesëmarrja në saj në aktivitet trajnues jashtë këtij programi, zhvilluar në 5 ditë trajnimi. Kjo, pasi legjislacioni i kohës parashikonte vetëm kufirin maksimal të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese, por jo një kufi minimal pjesëmarrjeje në aktivitete trajnuese, sikurse përcaktohet aktualisht në nenin 5, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke marrë në konsideratë frekuencën e angazhimit të gjyqtarës në aktivitetet trajnuese, sipas të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, gjyqtarja pikëzohet me 20 pikë.

Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale pikëzohet me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarës;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarës në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarës, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në

programin e formimit vazhdues të SH.M apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lektore dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Në formularin e vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, është referuar për angazhimin e saj në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo veprimtari të tjera të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore, mësimdhënie, etj. Konkretisht, rezulton angazhimi i gjyqtares në disa aktivitete profesionale i cili vlerësohet si veprimtari ndër-institucionale që kanë pasur si qëllim shkëmbimin e eksperiencave në fushën e së drejtës, si më poshtë:

- Konferencën e 2-të Akademike Ndërkombëtare mbi Integritet Evropian me temë “Integriteti i Europës Juglindore në Bashkimin Evropian-Sfidat” zhvilluar në datat 29-30 qershor 2013, për të cilën gjyqtarja është certifikuar edhe për kontributin e saj në diskutimet e kësaj konference, të botuar në revistën shkencore ndërkombëtare.⁶⁰

⁶⁰Certifikata në faqen 54 të dosjes së rivlerësimit

- Pjesëmarrje në tryezën/workshop Kombëtar “Mbi respektimin e të drejtave të autorit për sistemin gjyqësor dhe institucionet e tjera zbatuese”, organizuar nga Ministria e Kulturës, Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI), në datat 08-09 qershor 2016.
- Konferencë ndër-rajonale “Mbi menaxhimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhur me të”, organizuar nga Ministria e Kulturës, në datat 19-20 shtator 2016.
- Pjesëmarrje në tryezën/workshop ndër-rajonal “Të drejtat e autorit në epokën dixhitale”, organizuar nga TAIEX dhe Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit, në datat 5-6 dhjetor 2016.

Gjithashtu, gjyqtarja nëpërmjet shkresës të datës 10.11.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr.5882, datë 10.11.2023, paraqit vërtetimin me nr.158 prot., datë 03.11.2023 të Kolegjit Universitar “Pavarësia Vlorë”, sipas të cilit znj. {...} ka qenë e angazhuar pranë këtij universiteti si personel akademik me kohë të pjesshme, pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe shkencave Shoqërore, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Publike, në vitin 2013, në lëndët “E drejtë ndërkombëtare private”, “E drejtë kushtetuese” dhe “Arsyetim ligjor”.

Bazuar sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, duke qenë se rezultojnë të dhëna, vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në këtë periudhë vlerësimi, në veprimtari ndërinstitutionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, për treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitutionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:**

Sipas formularit të vetëvlerësimit⁶¹ për aftësitë profesionale të gjyqtarës dhe akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe dosjen personale të gjyqtarës, rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja ka realizuar publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës, si më poshtë:

- Në revistën Shkencore Ndërkombëtare “Diskutime”, Viti II, Nr.6–qershor 2013, me ISSN 1857-825X, artikulli i botuar “Sistemi gjyqësor në Shqipëri dhe procesi i integritimit / Judicial System in Albania and the integration process”.⁶²
- Në revistën “Gjeopolitika”, nr. VIII, viti 2013, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, me ISSN 2218-7294, artikulli i botuar “Diskriminimi dhe minoritetet”.⁶³
- Në revistën shkencore “Pavarësia”, nr. 1/2013, botim i Universitetit Pavarësia Vlorë, me ISSN 2304-2664, artikulli i botuar “Veprat penale të mjedisit / Criminal offenses of the environment”.⁶⁴

Në dosjen e rivlerësimit, gjyqtarja i ka bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit edhe publikimin ligjore në revistën “Çështje europiane dhe të Sigurisë-23”, artikulli i botuar “Ndhima e ndërsjellët juridike, Urdhri evropian i arrestit”,⁶⁵ botuar në vitin 2012 dhe për pasojë nuk mund të shërbejë si burim vlerësimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Bazuar për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duket të vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

Angazhimi i gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, për treguesin “Publikime ligjore akademike” angazhim i gjyqtarës dhe për këtë shkak pikëzohet me 5 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët

⁶¹Formulari i vetëvlerësimit, faqe 4 dhe 5, si dhe kopje e publikimeve bashkëlidhur formularit

⁶²Faqe 61-70 të dosjes së rivlerësimit

⁶³Faqe 71-80 të dosjes së rivlerësimit

⁶⁴Faqe 55-60 të dosjes së rivlerësimit

⁶⁵Faqe 81-89 të dosjes së rivlerësimit

Shkëlqyeshëm	98
--------------	----

PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	98	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	398	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR